



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr.1520/5 Prot.

Tiranë, më 02. 12.2024

V E N D I M

Nr. 286, Datë 02. 12. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa me nr. 228, datë 07.11.2024, e znj. E. Sh., kundër Bashkisë Vlorë (*Zyrës së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së të Ardhurave Vendore*) dhe Komisionerit për Shërbimin Civil, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se:

Znj.E. Sh., gëzon statusin e nënpunësit civil të konfirmuar, klasa IVA, me detyrë specialist pranimi dhe përpunimi të të dhënave, në Drejtorinë e të Ardhurave Vjetore, Bashkia Vlorë, sipas edhe shkresës nr. 15681, datë 14.12.2023.

Rezulton se nga ana e Bashkisë Vlorë është kryer shpallja për pozicionin “Përgjegjës në sektorin e përpunimit të informacionit”, në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore.

¹ Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon ankuesi me këtë shkak.

Në kushtet kur kërkuesja plotësonte kërkesat e ligjit, ka kryer aplikimin duke bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin ligjor. Megjithatë, nga ana e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Vlorë, i është bërë me dije se në dosjen personale i mungonte vlerësimi i fundit nga eprori direkt.

Edhe pse nga ana e personit përgjegjës nuk i është vendosur në dispozicion ky vlerësim për pesë vitet e ushtrimit të detyrës në institucion, pas disa përpjekjeve, është pajisur me “Vlerësimin e fundit nga eprori direkt” dhe e ka nisur në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore nëpërmjet shkresës nr. 10937 prot, datë 10.07.2024.

Në mënyrë të paprecedentë, nëpërmjet informimit me e-mail, kërkuesja vihet në dijeni nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, më datë 02.08.2024, me shkresën nr. 11307/1 prot, se: Pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe bazuar në shkresat hyrëse në Bashki me nr. 10757 prot, datë 08.07.2024, dhe nr. 10937 prot, datë 10.07.2024, rezulton se nuk plotëson kushtet për të vijuar procedurën.

Pavarësisht se afati për plotësimin e dokumentacionit, i informuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka qenë 5 ditë dhe kërkuesja e ka plotësuar këtë afat, përsëri kjo Drejtori informon kërkuesen se nuk kualifikohet për këtë pozicion, edhe pse vlerësimi nga eprori direkt ka qenë siç e kërkon ligji në masën “Mirë”.

Rezulton se skualifikimi paraprak jo vetëm që është i pavlefshëm, pasi janë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara, por gjithashtu kualifikimi më tej i kandidatëve të tjerë është gjithashtu i pavlefshëm, pasi kandidatët e kualifikuar për këtë pozicion janë në kushte shumë herë më të favorshme në krahasim me kërkuesen për të fituar të drejtën.

Procedura dhe zgjedhja e fituesit është kryer duke trajtuar në mënyrë të diferencuar kërkuesen, duke i shkaktuar një dëm moral dhe material.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Të përcaktohet nëse ka diskriminim në bazë të rrethanave të lartpërmendura.
2. Të shpallet e pavlefshme procedura paraprake e përzgjedhjes së kandidatëve.
3. Të shpallet e pavlefshme procedura e konkurimit të kandidatëve.
4. Të shpallet e pavlefshme vendimi i fituesit.
5. Të zhvillohen përsëri procedurat për pozicionin “Përgjegjës në sektorin e përpunimit të informacionit”, ku të jetë kandidate edhe ankuesja E. Sh.
6. Të vendoset gjobë ndaj institucioneve përgjegjëse që kanë lejuar një konkurim të parregullt, që kanë diskriminuar ankuesen, si dhe nuk kanë respektuar kërkesat ligjore të nënpunësit civil.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1520/2 prot., datë 08.11.2024, të Komisionerit, është kërkuar nga subjekti ankues që të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Me shkresën nr. 1520/3 prot., datë 21.11.2024, është administruar pranë Komisionerit, kthimi i përgjigjes së dërguar nga ana e palës ankuese, në të cilën ka sqaruar se: *Përsa i përket ankesës së shtetasës E. Sh., për diskriminim dhe për çdo shkak tjetër për të cilin kërkoni informacione të mëtejshme, ju bëjmë me dije:*

Konflikti i përshkruar është i natyrës administrative dhe diskriminimi pretendohet për një trajtim të diferencuar midis punonjësve me të njëjtin status profesional, atë të “nëpunësit civil”, ku shtetasja Englantina Shakaj, gjatë gjithë kohës së punësimit të saj (rreth 5 vite) pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vlorë, nuk është pajisur me vlerësim sipas Ligjit “Për nëpunësit Civil”. Madje, edhe në rastin kur është pajisur me këtë vlerësim nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nuk është bërë pjesë e procedurave paraprake të kandidimit, kur në fakt, për të njëjtin konkurim, një tjetër punonjëse që nuk plotësonte kriteret është përzgjedhur për të kandiduar dhe më pas për të fituar pozicionin e punës.

Në kushtet kur ka një trajtim të pabarabartë për një shkak (për të cilin nuk jemi në dijeni), por ndihet diskriminimi, kërkojmë nga ana juaj që të investoheni juridikisht në Drejtorinë e të Ardhurave Vlorë, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Kryetarit të Bashkisë Vlorë, për të evidentuar saktësisht arsyen e trajtimit të pabarabartë.

Duke qenë se këto institucione, as përfaqësueses ligjore, nuk i kanë vendosur në dispozicion asnjë informacion dhe asnjë dokumentacion sa i përket procedurës së ndjekur, do të thotë se ka një shkak për mungesën e trajtimit, shkak i cili mund të lidhet ndoshta edhe me ndonjë prej shkaqeve të listuara në ligj, por që nga ana jonë nuk kemi mundësi ta evidentojmë.

Mbi të gjitha, mos pajisja me vlerësime për një periudhë 5-vjeçare, në dëm dhe në mungesë të respektimit të statusit të nëpunësit civil, tregon për një diferencim të kryer me vetëdije, pasi këto vlerësime janë të nevojshme për ngritjen në detyrë apo për lëvizje paralele, si detyrime të ligjit.

Këtë çështje nuk po e ndjekim gjyqësisht, por i jemi drejtuar Komisionerit për Shërbimin Civil lidhur me shkeljet e natyrës administrative nga drejtoritë përkatëse.

Nuk kemi dokumentacion shtesë, pasi institucionet denjojnë të na vënë në dispozicion, qoftë edhe një kthim përgjigje për situatën.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Përsa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh³.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesja nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

² Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar citon se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.*”

³ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Përveç sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se çështja e moskthimit të një përgjigjeje zyrtare nga ana e Bashkisë Vlorë, lidhur me kërkesën për informacion dhe dokumentacion për procedurën e konkurrimit për ngritjen në detyrë të znj. E. Sh., në bazë të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë kontekst, rekomandohet që subjekti ankues të depozitojë ankesën pranë institucionit të përmendur më sipër.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues znj. E. Sh., pasi bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA